

D 651

.A5 D3

Copy 1

ALBANIA'S

Rights and Claims to Independence
and
Territorial Integrity

Te Drejtat dhe Kerkimet e Shqiperise
per
Independence dhe Teresine e Vendit



ALBANIA'S

Rights and Claims to Independence
and
Territorial Integrity



Te Drejtat dhe Kerkimet e Shqiperise
per
Independence dhe Teresine e Vendit

Christo A. Wanko

1718

I 651
. A 5 I 3

Copyright 1918
by
CHRISTO A. DAKO.

Gift
Author
DEC 15 1918



ALBANIA'S Claims and Rights to Independence and Territorial Integrity[†]

Ptolemy is the earliest writer who makes mention of the Albanians, but in fact the Skhiptars, sons of the Rock Eagle, as they call themselves, are the most ancient existing race in Europe, the autochthonous inhabitants of the Balkan Peninsula, which they have ruled for thousands of years before the Barbarians ever crossed the Danube. They are the descendants of the ancient Macedonians, Illyrians and Epirotes, who are the offsprings of the Pelasgians.

The Albanians are of a stock with striking physical and mental characteristics. History gives us a list of celebrated Albanians, surprising both in quality and quantity for the wide field in which distinction has been won. In all ages the Albanians have forced their way to the front in the affairs of the world. Alexander the Great, Pyrrhus, Teuta, Scanderbeg, Ali Pasha of Janina, Mehmet Ali Pasha, the liberator of Egypt, Crispi, the great statesman of

[†] This is the text of the statement regarding Albania's rights and claims to independence and territorial integrity which was sent to President Wilson.

Italy, and Trikupis, the statesman of Greece are but a few of these.

The heroic resistance offered by the Albanians in the past against the Romans, the Goths, the Huns, the Serbs, the Bulgars, and the Normans has been nothing short of marvellous. They have survived five great Empires and successfully resisted every effort to denationalize them. They have retained their language, their national customs and traditions throughout all centuries, thus proving to be incapable of being conquered and assimilated.

In the fifteenth century, while Europe was enjoying the blessings of Renaissance, the Albanians led by the celebrated hero George Castriota Scanderbeg, overwhelmed more than a score of the Turkish armies, some of which were under the personal command of the Sultans and hindered them from carrying their invasion any farther into Europe, thus insuring peaceful times for the western nations and enabling them to reach their high state of civilization and learning.

After the death of Scanderbeg our country fell into the misrule of the Ottomans, who inaugurated a system of oppression and persecution, and deprived

them of the sacred right to educate themselves in their own language while the foreign propaganda and intrigue had a wide open door and a free hand to divide and denationalize the Albanian nation.. This foreign propaganda and intrigue was of such a nature that it has not disappeared entirely from amongst us even in this country, which is void of such manoeuvres.

Yet, the vitality of the Albanian nation as a whole is such that it kept intact the national characteristics, and it arose more than once demanding territorial integrity and independence; but some of the Great Powers, for the sake of their own interests preferred to maintain the status quo of Turkey rather than sanction the independence of Albania.

In 1912 during the Balkan war, Albania became the bone of contention of Serbia, Greece, Bulgaria and Montenegro, which were contemplating its full partition; but Italy and Austria stepped in to prevent such an eventuality. Meanwhile the Albanians under the leadership of their veteran statesman Ismail Kemal Bey Vlora proclaimed the independence of their country and appealed to Europe for the integrity of

Albania. A month later the London Conference compelled by this real and democratic force of the creation of this new state, and as a confession of faith in the principle of nationality, sanctioned the independence of Albania, which was proclaimed by the Albanians themselves on the 28th of November, 1912.

Unfortunately a great part of the Albanian territory was unjustly and unwisely severed from its trunk and grafted on Montenegro, Serbia and Greece. Our greedy neighbors were not satisfied with what they got thru the London Conference, but at once started and invaded the country in spite of their solemn declarations that they accept the decisions of the European Concert, and destroyed the machinery of the newly born state before it had time to get on its feet. The atrocities and massacres committed by the invading forces during the summer of 1914, just preceding the European War, will remain a bloody stain in the history of the world.

We are glad to learn that the Greek and the Serbian statesmen and patriots are beginning to realize that the natural field of expansion is not towards Southern Albania or "Epirus," or towards Northern Albania or "Old Serbia," whose pop-

ulation is entirely Albanian by race, language and sentiment; but for Greece, towards the east, the islands of the Aegean Sea and along the Asia Minor coast; and, for Serbia, towards the north, Bosnia, Herzegovina, Croatia, etc.

At present Albania, though neutral created by the European Concert, is overrun by the belligerent Powers, and is suffering in silence, even more than Belgium.

Ever since the beginning of the great war the Albanians, faithful to the just cause of the Allies—who are fighting for the triumph of the sacred principles of nationalities—and loyal inhabitants of the U. S., are rejoicing to hear the noble voice and know of President Wilson's demands for the protection of the rights of the small nationalities. Our joy is greater now seeing the American flag crossing the Atlantic having as motto, "Reign of law, based upon the consent of the governed and sustained by the organized opinion of mankind."

Considering that all attempts made in the past to solve the near East problem which did not take into account the rights of the Albanian element have proved to be entirely failures; considering that so long as a single nation any-

where remains under the heels of the conquerors, so long the peace of the world is insecure; considering that the peace following this war cannot be durable, cannot be permanent if ancient injustices are perpetuated; considering the firm determination of the Allies to fight for a final settlement, we are fully convinced that the great and noble principles of the American nation will triumph, and that Albania, among other small nations will be granted her just claims for full political and economical independence and territorial integrity.

The Albanians justly demand all lands in the west of the Balkan Peninsula, which are inhabited by Albanians. The boundary can be easily followed on any map. From the Boiana river it keeps to the former Montenegrin frontier on the north till it reaches the district of Novibazar, south of Berane, whence it follows the river Ibar to Mitrovitza. It includes the railway line as far south as Kupruli taking in Ferizovik and Uskup. From Kupruli the boundary runs south to the angle of the Monastir railway near Florina between lakes Prespa and Ostrovo and then strikes east to a point nearly south of Lake Prespa, leaving out Kastoria,

whence it runs due south to the old Greek frontier.

Wadham Peacock in his book, "Albania, the foundling state of Europe," speaking of the territory inhabited by Albanians and of their claims says, "This attempt at the delimitation of the boundary would no doubt have been accepted by the London Conference if the Albainans were strong enough or popular enough to command a propaganda such as has been worked by the friends of the Greeks, the Bulgars and the Serbians, for it included the country in which the Albanians are undoubtedly in the majority, and in which the other nationalities have only maintained themselves by the most unscrupulous religious and political intrigues."

Mr. Rene Pinon, another impartial authority on the Balkan problem speaking on the same subject says: "Des plaines du Vardar à l'Adriatique de la Thessalie au Montenegro, l'Albanais est maitre par le droit du premier occupant et par le droit du plus fort."

To mighty, just and freedom-loving America falls the task, yea the honor of defending the right claims of this friendless nation that it may enjoy the right of developing freely and peacefully

a civilization of her own, being entitled as a distinct nationality with its own race and language to the same status accorded to all other small states.

CHRISTO A. DAKO.
MIHAL GRAMENO.

Te Drejtat edhe Kerkimet e Shqiperise per independence edhe per Teresine e Vendit.*

Ptolomeu është i pari shkrimtar, i cili bën fjalë për Shqipëtarët, mirë po Shqipëtarët, bijtë të Shkabës Malësore, sikundër ata e quajnë veten e tyre, janë raca më e vjetër, që ndodhet në Evropë, ndenjësit autoktonë të Sinisisë Ballkanit, të cilën e qeverisnë për mijëra vjete më parë se të kapërxejnë Barbarët Tunën. Shqipëtarët janë stërnipërit të Maqedhonasvet vjetër, të Ilirianëvet edhe të Epirotëvet, të cilët ishin zbritësit e Pelasgëvet.

Shqipëtarët janë prej një brume me cilësi fizike edhe mendore të çquara. Historia na jep një listë Shqipëtarësh të çquarë si nga cilësia kështu edhe nga sasia, edhe fushatën e gjerë në të cilën vepëruan. Në tërë brezat Shqipëtarët kanë qendruarë në ballë, në punërat e botës. Aleksandri i Math, Pirua, Tevta, Skënderbeu, Ali Pashë Janina, Mehmet Ali Pasha, që liroj Misirin, Crispi, burë shteti i Italisë, Trikupi, burë shteti i Greqisë, janë ca nga këta.

* Ky është teksti shqip i Memorandumit që ju dergua Presidentit Wilson më 20 Korrikut prej ZZ. Christo Dako edhe Mihal Grameno.

Qendrimi heroik që treguan Sqipëtarët në kohërat e kaluara kundër Romanëve, Gothëve, Hunëve, Serbëve, Bullgarëve edhe Normanëve s'është m'e pakët se një çudi. Të bijtë të Shkabonjë's përmijetuan pesë imperatori edhe udobisht kundrështuan ç'do përpjekje për t'i çkombësuar. E ruajtne gjuhën, zakonet kombëtare edhe traditat në tërë brezat, edhe kështu e provuan se janë një komb që nuku munt të vihet nënë thundrë ose të tretet.

Në të 15-tin shekull, kur Evropa ishte dyke gëzuar bekimet të *Përlindjes*, Shqipëtarët nënë udheheqjen të heroit tyre të famëshme George Castriota Scandërbeg, muntnë më shumë se 20 ushtëri Tyrke, nga të cilat disa ishin nënë komandën personale të Sulltanevet vetë, edhe kështu i ndaluan t'a zgjatin pushtimin e tyre më tej në Evropë, edhe kështu ju siguruan paqja popujvet perëndimit edhe ju ndihmuan të harijnë shkallën e lartë të diturisë edhe të qytetërimit.

Pas vdekjes të Skëndërbeut, vëndi ynë ra nënë qeverimin të keq të Ottomanëve, të cilët nisë edhe vunë në vepërim një sistem shkelje edhe ndjekje kundër Shqipëtarëve, edhe u mëhuan të drejtën e shenjtë për t'u arësuar në gjuhën e vet, kurse propagandës edhe intrigës huaj i

hapnë dyertë edhe i dhanë liri të plotë t'e ndajnë edhe t'e çkombësojnë kombin Shqipëtar. Këjo propagandë edhe intrigë e huaj ka pasur një të tillë natyrë sa edhe nuk është çdukur krejt nga redhi ynë, edhe në këtë vënt, i cili është i zbrazët nga të këtilla manevra.

Me gjithë këto, fuqia jetore e kombit Shqipëtar si një trup është e tillë sa mundi të ruanjë të pa cënuara cilësitë kombëtare, edhe më shumë se një herë u ngrit dyke kërkuar tërësinë të vëndit edhe independencën; mirë po disa nga Fuqitë e Mëdha, nga shkakut i interesave tyre, e gjetnë për më mirë të përmbajnë *status quo* të Tyrqisë, se sa të njohin edhe të vulosin independencën të Shqipërisë.

Më 1912, në kohën të luftës Ballkanike, Shqipëria u bë kockë mosmarëveshjeje midis Sërbisë, Greqisë, Bullgarisë edhe Malit Zi, të cilat qëllonin ndarjen e saj; po Italia edhe Austria hynë në mest për të ndaluarë një ngjarje të tillë. Më këto e sipër, Shqipëtarët nënë udhëheqjen të veteranit burë Shteti, Ismail Qemal Bey Vlora, proklamuan independencën të vëndit tyre edhe i adresuan Evropës një thirrje për tërësinë të Shqipërisë. Një muaj më von, Konferenca e Londrës e shtrënguarë prej kësaj fuqie

reale edhe demokratike që krijoj këtë shtet të ri, edhe si një dëshminë të besimit saj në parimin të kombësisë vulosi independencën e Shqipërisë, të cilën independencë e proklamuan Shqipëtarët vehtë më 28 të Vjeshtës tretë 1912.

Fatkeqërisht një pjesë e madhe e vëndit Shqipërisë padrejtësisht edhe pa urtësisht u çkëput nga trupi i saj edhe ju dha Malit Zi, Sërbisë edhe Greqisë. Fqinjët tanë lakmonjës nuku u kënaqnë me atë që muarnë me anën të Konferencës Londrës, po për një herësh nisnë të shkelin vëndin, me gjithë se kishin deklaruar zyrtarisht se pranojnë vendimet të Mbledhjes Evropës, edhe çkatëruan maqinërinë të këtij shteti që posa kishte lindur, më parë se të këtë kohë të ngrihet më këmbë. Ligësitë edhe therjet që u bënë në Shqipëri prej ushtërivet invadore, në verë të vitit 1914, pak kohë përpara luftës Evropjane do të mbeten një leqe gjaku në histori të botës.

Gëzohemi të mësojmë se burat Shteti edhe patriotët të Greqisë edhe të Sërbisë zunë të kupëtojnë se fusha naturale për zgjerimin e tyre nuku është as Shqipëri'e Jugës ose "Epiri," as Shqipëri'e Veriut, ose "Sërbia e Vjetër," ndenjësit e të cilavet vise janë Shqipëtarë edhe nga raca, edhe nga gjuha edhe nga

ndjenjat; po, për Greqinë, në lindje, në nisë të Detit Aegje, edhe në Asi të Vogël; edhe, për Sërbinë, në veri, në Bosnjë, Herzegovinë, Kroati, etj. . .

Sot për sot Shqipëria, me gjithë që u vendos prej Evropës të jetë neutrale, është shkellur prej Fuqivet luftonjësve, edhe po vuan në heshtje më shumë se Belgjia.

Që kur se nisi lufta e madhe, Shqipëtarët, besnikë të çështjes së drejtë të Aliatëvet të cilët po luftojnë për triumfin të parimit të shenjtë të kombësisë edhe ndenjës besnikë të Shtetevet të Bashkuara, po gëzohen dyke dëgjuar zërin fisnik edhe dyke mësuar kërkimet të Prezidentit Wilson për mprojtjen të të drejtavet të kombësivet të vogla. Gëzimi ynë është sot edhe më i math dyke parë Flamurin Amerikan të kapërxenjë Atlandikun, dyke pasur si krye fjalë: "Të mbretëruarit të nomit, dyke pasur si themel lejën ose dashjen të të qeverisurvet edhe përkrahjen të opinionit të organizuar të njerëzimit."

Dyke ditur se tërë përpjekjet që u bënë, në kohërat e kaluara për të zgjidhur problemën e Ballkanit, pa marë ndër sy të drejtat e elementit Shqipëtar, ranë krejt; dyke ditur se sa kohë një komp, kudo që të jetë, mbetet nënë dhundrë të

pushtonjësve, aqë kohë paq'e botës është e pasiguruar; dyke ditur se paqja që do të pasonjë këtë luftë nuku do të jetë e qëndruarshme edhe e gjithëmonëshme, në qoftë se padrejtësitë e më parëshme vazhdojnë; dyke ditur qëndrimin të patundur të Aliatëve për të luftuar për një zgjidhje të sosur, jemi plotërisht të bindur se parimet e mëdha edhe fisnike të popullit Amerikan do të triumfojnë, edhe se Shqipërisë, midis të tjerave kombësi të vogla, do t'i jepen kërkimet e saja të drejta për independencë të plotë politike edhe ekonomike, si edhe tërësia e vëndit.

Shqipëtarët drejtësisht kërkojnë tërë viset ne perëndim të Senisisë Ballkanit, të cilat janë të ndenjura prej Shqipëtarësh. Kufinë të saj lehtazi munt t'ë ndjekim në ç'do hartë. Nga lumi Bojana, këjo kufi pason kufinë e vjetër të Malit Zi, në veri, gjer sa prek krahinën të Novipazarit, në jugë të Beranës, që kuni të ndjekë lumin Ibar gjer në Mitrovicë. Kufia pushton udhën e hekurtë gjer në Qypruli dyke marë përbrenda Ferrizovikun edhe Yskypin. Prej Qyprulisë kufia drejtohet në jugë edhe pret udhë e hekurtë Manastir Selenik pranë Follorinës, dyke shkuar midis liqenevet të Prespës edhe të Ostrovës, edhe pastaj

drejtohet në lindje gjer në një pikë, në jugë të liqenit Prespës dyke lënë jashtë Kosturin; së këtejmi mer përsëri drejtim jugor edhe dyke u zgjatur prek kufinë e vjetër të Greqisë.

Wadham Peacock, në librën e tij, "Albania, the foundling State of Europe," dyke folur përmi vendin ndenjor prej Shqipëtarësh edhe për kërkimet e tyre thotë, "Këjo përpjekje për të hequr kufinë të Shqipërisë, pa dyshim se do të ishte akseptuar prej Konferencës Londrës, po të ishin Shqipëtarët mjaft të fortë ose mjaft popullorë për të komanduar një propagandë si atë që organizuam miqt'e Grekërvet, të Bullgarëvet, edhe të Sërbëvet, sepse pushtonte vëndin, në të cilin Shqipëtarët me të vërtet formojnë shumicën, edhe në të cilin vënt kombësitë e tjera qendruan dyke përdorur intrigat më të dobëta fetare edhe politike."

Zoti Rene Pinon, një tjetër shkronjës i paanëshmë në problemën e Ballkanit, dyke folur përmi këtë themë thotë, "Prej fushavet të Vardarit gjer në Adriatik, prej Thessalisë gjer në Mal të Zi, Shqipëtari është zot, edhe nga se është i pari ndenjës, edhe nga se është më i forti në këto visë."

Amerikës se fuqishme, së drejtë edhe

liri dashëse i bije bara, po edhe nderi,
për të mprojtur kërkimet të këtij kombi
jetim, që të munt të gëzojnë edhe Shqi-
pëtarët të drejtën për të çvilluar lirisht
edhe në paqtim qytetërimin e tyre dyke
pasur të drejtë, si një komp i veçantë,
nga një racë e veçantë, edhe më një
gjuhë të veçantë, t'i jepet gjith ay shtet
si edhe tërë kombësivet të tjera të vogla.


CHRISTO A. DAKO.
MIHAL GRAMENO.







LIBRARY OF CONGRESS



0 001 452 165 3